

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alineja 11, në lidhje me nenin 92 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14) dhe nenit 15 paragrafi 1 alineja 7 dhe neni 39 paragrafi 1 alineja 3 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele nr. 01-4351/1 nga data 29.08.2014, e në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-5903/3 nga data 04.12.2014, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në mbledhjen e saj të 20-të, të mbajtur më 04.12.2014, miratoi

**RREGULLORE**  
**për obligimet për emetimin e programit të krijuar burimor, muzikës,**  
**programit dokumentar dhe atij artistik**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1  
**Lënda e Rregullores**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e zbatimit të dispozitave nga neni 92 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në drejtim të obligimeve të radiodifuzerëve për emetimin e programit të krijuar burimor në Republikën e Maqedonisë në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive jo shumicë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, për emetimin e muzikës instrumentale, vokale dhe/ose vokale-instrumentale si dhe për prodhimin dhe emetimin e programit vendas dokumentar dhe artistik.

Neni 2  
**Definicionet**

Shprehje të caktuara, që janë përdorur në këtë Rregullore e kanë këtë domethënie:

- **Program i krijuar burimor** në Republikën e Maqedonisë në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive jo shumicë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: program i krijuar burimor) është programi i krijuar nga ofrues të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele producentëve të pavarur, të themeluar në Republikën e Maqedonisë në të cilën biseda burimore emitohet në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive jo shumicë që jetojnë në RM, si dhe programet që janë vepra të trashëgimisë kulturore audiovizuele në RM;
- **Vepra të trashëgimisë kulturore audiovizuele të RM-së** janë pasuritë audiovizuele dhe fonoteke që paraqesin trashëgimi kulturore të RM-së dhe që janë të dedikuara për transmetime publike;
- **Program i prodhimit personal** është programi radio ose televiziv i krijuar me iniciativë dhe në organizim të vet radiodifuzerit, program i porositur nga radiodifuzeri (prodhim i porositur) ose i prodhuar në koproduksion;

## II. PROGRAM I KRIJUAR BURIMOR

### Neni 3

#### **Çfarë nuk konsiderohet si program i krijuar burimor**

Sipas prodhimitarisë, programi i krijuar burimor mund të jetë i prodhimit personal të radiodifuzerit ose i krijuar nga radiodifuzer tjerë ose nga producentë të pavarur të themeluar në Republikën e Maqedonisë.

Në program të krijuar burimor bëjnë pjesë të gjitha llojet e programeve të emetuara nga radiodifuzeri, përvec lajmeve ose ditarëve të radios ose televizionit; transmetimet ose incizimet e seancave të organeve të pushtetit; transmetimet ose incizimet e ngjarjeve shoqërore-politike; programet me horoskop, tarot, parashikues ose

Interpretues të ëndrrave; spotet muzikore dhe përmbajtjet që nuk i nënshtrohen klasifikimit të përcaktuar në pikën 17 të Udhëzimit për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuale<sup>1</sup> (audiovizuale dhe audio komerciale

Komunikimet; publikimet e radiodifuzerit në lidhje me programet e tija personale; deklarata me interes publik; apele për qëllime humanitare; intermexo; programe fetare, shërbesa dhe predikime; programe për kulturë fizike dhe rekreacion; dhe shpicat për hapje dhe mbyllje, xhingla dhe avizo).

### Neni 4

#### **Gjuha në të cilën plotësohet obligimi**

Shërbimi publik për radiodifuzion e realizon obligimin për emetimin e programit të krijuar burimor në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive joshumicë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, varësisht nga ajo se në cilën ose cilat gjuhë emetohet shërbimi programor.

Shoqëritë tregtare të radiodifuzionit dhe institucionet jofitimprurëse të radiodifuzionit janë të obliguara që programin e krijuar burimor ta plotësojnë në gjuhën në të cilën e emetojnë pjesën biseduese të shërbimit programor, në pajtim me lejen për emetim të radios ose televizionit.

Shoqëritë tregtare të radiodifuzionit dhe institucionet jofitimprurëse të radiodifuzionit, që me lejen për emetim janë të obliguar që të emetojnë pjesën biseduese të shërbimit programor në më shumë gjuhë, obligimin për programin e krijuar burimor mund ta plotësojnë në të gjitha gjuhët e theksuara në leje

### Neni 5

#### **Emetimi i premierës**

Në përqindjen e programit të krijuar burimor llogaritet vetëm emetimi i premierës së llojeve të programeve gjatë një dite, te çdo radiodifuzer në veçanti.

<sup>1</sup> Udhëzimi për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuale, në të cilën referohet në nenet 3 dhe 6 të kësaj Rregullore, është publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr.171/14.

## Neni 6

### **Mënyra e përlogaritjes së përqindjes**

Te shërbimet programore televizive, përqindja e detyrueshme për program të krijuar burimor, llogaritet nga koha e përgjithshme e programit të emetuar gjatë një dite, me përjashtim të kohës që ndahet për përmbajtjen që nuk i nënshtrohen klasifikimit, të përcaktuara në pikën 17 të Udhëzimit për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuale.

Te shërbimet programore të radios, përqindja e detyrueshme për program të krijuar burimor, përlogaritet nga koha e përgjithshme e llojeve të programeve të emetuara në pjesën biseduese të programit gjatë një dite.

## Neni 7

### **Paralajmërimi i veprave të trashëgimisë kulturore audiovizuale të RM**

Gjatë emetimit të programeve që janë vepra të trashëgimisë kulturore audiovizuale në RM, duhet tju paraprij paralajmërim adekuat bisedues ose vizual në të cilën është theksuar emri i autorit, titulli i veprës, viti i krijimit dhe informata tjera për veprën.

## **III. MUZIKA INSTRUMENTALE, VOKALE DHE/OSE VOKALE - INSTRUMENTALE**

## Neni 8

### **Zhanret muzikore me të cilat plotësohet obligimi shërbimeve programore televizive**

Shërbimet programore televizive të formatit të përgjithshëm dhe shërbimet televizive të shërbimit publik të radiodifuzionit, obligimin për emetimin e muzikës popullore dhe argëtuese instrumentale, vokale dhe/ose vokale instrumentale e plotësojnë përmes këtyre zhanreve dhe stileve muzikore të përcaktuara në pajtim me Klasifikimin nacional të trashëgimisë kulturore ("Gazeta zyrtare e RM-së nr. 37/06") dhe Klasifikimit universal decimal:

- Muzika popullore tradicionale (muzikë burimore – e paautorizuar), etno/muzika nga bota dhe muzika e bashkëkohore popullore (muzika e bashkëkohore popullore në frymë popullore, turbo folk, disko folk, pop folk);
- Muzika argëtuese (e popullarizuar): pop (disko, dens, hip-hop, pop-rok, ritam dhe bluz, soul, frank, rap, rege, ska, dab etj), xhez (regtajm, diksilend, sving, bi-bap, hard-bap, kul xhez, fri zhez, fjuzhn, smut, xhez, ajsid xhez etj), bluz, rok/rok end roll (rokabili, ajsid-rok, hard-rok, pank, folk-rok, rok psikodelik, rok progresiv, hevi-metal, nju vejev, rok alternativ, granxh, brit-pop, indi-rok, soft-rok etj), muzikë elektronike/tekno (haus, ejsid, goa, trans, xhangl, dram etj.).

#### Neni 9

### **Lëshimi prej 5% në ndarjen në mes të muzikës popullore dhe argëtuese te shërbimet televizive**

Lëshim prej 5% në krahasim me kërkesat për përfaqësim të barabartë të muzikës popullore dhe argëtuese në muzikën e emituar në përgjithësi gjatë një jave, te shërbimet programore televizive të formatit të përgjithshëm, nënkuptojnë 24 minuta më shumë ose më pak në shpërndarjen në mes të muzikës popullore dhe argëtuese.

Lëshim prej 5% në krahasim me kërkesat për përfaqësim të barabartë të muzikës popullore dhe argëtuese në muzikën e emituar në përgjithësi në periudhën prej ora 07:00 deri në ora 19:00, te shërbimet programore televizive të formatit të përgjithshëm, nënkuptojnë 12 minuta më shumë ose më pak në shpërndarjen në mes të muzikës popullore dhe argëtuese.

Lëshim prej 5% në krahasim me kërkesat për përfaqësim të barabartë të muzikës popullore dhe argëtuese në muzikën e emituar në përgjithësi gjatë një jave, te shërbimet programore televizive të Shërbimit publik të radiodifuzionit, nënkuptojnë 42 minuta më shumë ose më pak në shpërndarjen në mes të muzikës popullore dhe argëtuese.

Lëshim prej 5% në krahasim me kërkesat për përfaqësim të barabartë të muzikës popullore dhe argëtuese në muzikën e emituar në përgjithësi në periudhën prej ora 07:00 deri në ora 19:00, te shërbimet programore televizive të shërbimit publik të radiodifuzionit, nënkuptojnë 21 minuta më shumë ose më pak në shpërndarjen në mes të muzikës popullore dhe argëtuese.

#### Neni 10

### **Mënyra e përllogaritjes së obligimit për emetimin e muzikës te shërbimet e radios**

Përqindja e detyrueshme e muzikës instrumentale, vokale dhe/ose vokale-instrumentale në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive jo shumicë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, te shërbimet programore të radios, përllogaritet nga muzika e emetuar në përgjithësi nga të gjitha zhanret dhe stilet gjatë një dite.

#### Neni 11

### **Gjuha në të cilën plotësohet obligimi**

Shërbimi publik për radiodifuzion e realizon obligimin për emetimin e muzikës vokale dhe/ose vokale-instrumentale në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive jo shumicë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, varësisht nga ajo se në cilën ose cilat gjuhë emetohet shërbimi programor.

Shoqëritë tregtare të radiodifuzionit dhe institucionet jofitimprurëse të radiodifuzionit janë të obliguara që muzikën vokale dhe/ose vokale-instrumentale ta plotësojnë në gjuhën në të cilën e emetojnë pjesën biseduese të shërbimit programor, në pajtim me lejen për emetim të radios ose televizionit.

Shoqëritë tregtare të radiodifuzionit dhe institucionet jofitimprurëse të radiodifuzionit të cilat me lejen për emetim janë të obliguar që ta emetojnë pjesën biseduese të shërbimit programor në më shumë gjuhë, obligimin për emetimin e muzikës vokale dhe/ose vokale-instrumentale mund ta plotësojnë në të gjitha gjuhët e theksuara në leje.

## **IV. PROGRAMIT VENDAS DOKUMENTAR DHE ARTISTIK**

### **Neni 12**

#### **Gjuha në të cilën plotësohet obligimi për program vendas dokumentar dhe artistik**

Shërbimi publik i radiodifuzionit, obligimin për prodhimin dhe emetimin e programit vendas dokumentar dhe programit artistik e plotëson në gjuhën maqedonase dhe/ose në gjuhët e bashkësive jo shumicë në të cilën e emeton programin.

Shoqëritë tregtare të radiodifuzionit në nivel shtetëror që kanë leje për shërbim programor të formatit të përgjithshëm janë të obliguar që kërkesën për prodhimin dhe emetimin e programit vendas dokumentar dhe programit artistik ta plotësojnë në atë gjuhë në të cilën janë të obliguar që ta emetojnë pjesën biseduese të shërbimit programor, në pajtim me lejen për emetim.

Shoqëritë tregtare të radiodifuzionit në nivel shtetëror që kanë leje për shërbim programor të formatit të përgjithshëm janë të obliguar me lejen për emetimin e pjesës biseduese të shërbimit programor në më shumë gjuhë, obligimin për prodhimin dhe emetimin e programit vendas dokumentar dhe programit artistik ta plotësojnë në ato gjuhë në të cilën janë të obliguar që ta emetojnë pjesën biseduese të shërbimit programor, në pajtim me lejen për emetim.

Shërbimi publik i radiodifuzionit dhe shoqëritë tregtare të radiodifuzionit nga paragrafi 3 i këtij neni, programit dokumentar dhe programit artistik, mund ta prodhojnë në dy ose më shumë gjuhë, gjatë vlerësimit të plotësimit të obligimit, numri i orëve të prodhuara numërohet vetëm njëherë, nëse bëhet fjalë për të njëjtin program dokumentar ose program artistik.

### **Neni 13**

#### **Koproduksioni në mes të shoqërive tregtare të radiodifuzionit**

Në rastet kur dy ose më shumë shoqëri tregtare të radiodifuzionit në koproduksion prodhojnë program vendas dokumentar ose program artistik, gjatë vlerësimit të plotësimit të obligimit, numri i orëve të prodhuara në mënyrë të përbashkët ndahet në mënyrë të barabartë me të gjithë koproducentët, ose sipas pjesëmarrjes në shpenzimet për prodhimin e programit nëse ajo dallohet në mënyrë të konsiderueshme.

### **Neni 14**

#### **Obligimet për njoftimin e Agjencisë**

Shërbimi publik i radiodifuzionit dhe shoqëritë tregtare të radiodifuzionit në nivel shtetëror të cilët kanë leje për shërbim televiziv të formatit të përgjithshëm, janë të obliguar që pesë ditë para emetimit të programit vendas dokumentar dhe programit artistik, me të cilët i plotësojnë obligimet e parapara në nenin 92 paragrafët 8 dhe 9 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, ta njoftojnë Agjencinë për datën dhe kohën e emetimit të tyre.

Obligimi për njoftim nga paragrafi 1 i këtij neni, vlen për të gjitha programet të cilat radiodifuzeri i emeton me qëllim që të plotësojë obligimet për programin vendas dokumentar dhe programin artistik, pa marrë parasysh nëse ka për qëllim që ti paraqesë për kompensimin për mbulimin e shpenzimeve në shumë prej 50%, i paraparë në nenin 92 paragrafi 10 i Ligjit.

## **V. DISPOZITAT PËRMBYLLËSE**

### **Neni 15**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, pushon vlefshmëria e Rregullores për zbatimin e dispozitave në lidhje me mbrojtjen dhe kultivimin e identitetit kulturor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/06).

### **Neni 16**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e ardhshme pas ditës së publikimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë"

**Agjencia për shërbime  
mediatike audio dhe audiovizuele**

**Kryetar i Këshillit**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Nr. 01-5976/1  
04.12.2014  
Shkup